



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN  
MBI DOKUMENTET E ISH  
SIGURIMIT TË SHTETIT**

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN  
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN  
E TË DHËNAVE PERSONALE**

Nr. 206/1 Prot. Datë 24/04/2017

Nr. 686/1 Prot. Datë 24/4/2017

### MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

**Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit (më poshtë AIDSSH),**  
përfaqësuar nga Kryetari, Znj. Gentiana Sula;

dhe

**Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (më poshtë  
KDIMDP),** përfaqësuar nga Komisioneri, Z. Besnik DERVISHI;

Për të nxitur transparencën si një model për shoqërinë në garantimin dhe zbatimin e të drejtave  
themelore të njeriut;

Për të konsoliduar bashkëpunimin tonë në drejtime konkrete;

*palët* bien dakord të lidhin këtë **Marrëveshje Bashkëpunimi** (më poshtë “**Marrëveshja**”).

#### **Neni 1**

#### **Objekti**

Objekti i kësaj **Marrëveshje** është institucionalizimi i marrëdhënieve për aplikimin e procedurave që thjeshtojnë bashkëpunimin e ndërsjellë të palëve, në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, veçanërisht në fushën e të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Bashkëpunimi i palëve do të realizohet mbi baza të njëjta dhe mbi parimin e reciprocitetit.

## **Neni 2**

### Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj **Marrëveshje** është Ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

## **Neni 3**

### Sfera e bashkëpunimit

**AIDSSH** dhe **KDIMDP** angazhohen të bashkëpunojnë në:

1. dhënien e mendimeve dhe sugjerimeve në hartimin e akteve të ndryshme, që prekin objektin e veprimit të palës tjetër;
2. shkëmbimin e vazhdueshëm të njohurive dhe praktikave të reja;
3. organizimin e aktiviteteve të përbashkëta;
4. ngritjen e grupeve të përbashkëta të punës, në veçanti në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;
5. dhënien dhe shkëmbimin e mendimeve për aktet ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me të dhënat personale;
6. përgatitjen dhe shkëmbimin e botimeve .

## **Neni 4**

### Të drejta dhe detyrimet e palëve

Në përmbushje të kësaj **Marrëveshje**, **AIDSSH** dhe **KDIMDP** kanë këto të drejta dhe detyrime:

1. të marrin pjesë në takime të organizuara nga secila palë, për çështje që janë objekt i kësaj Marrëveshje;
2. të kërkojnë informacione palës tjetër në funksion të veprimtarisë përkatëse;
3. të kërkojnë mendime dhe sugjerime njëra-tjetrës, në rastet e nxjerrjes së akteve të propozuara, që prekin objektin e veprimtarisë së palës tjetër;
4. të bëjnë të disponueshëm kundrejt kërkesave të arsyetuara dokumente/informacione të punës;
5. të bashkërendojnë punën për hartimin e programeve të transparencës;
6. të asistojnë njëra - tjetrën në hartimin dhe miratimin e rregulloreve, veçanërisht sa i përket sigurisë së të dhënave personale dhe sigurisë së informacionit, sipas ligjit nr.45/2015 dhe ligjeve nr. 119/2014 dhe nr. 9887/2008;
7. të ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të dhëna nga pala tjetër;
8. të organizojnë konferenca, takime, workshop-e për të nxitur ndërgjegjësimin e të gjithë atyre që u janë përpunuar/ruajtur të dhënat nga ish-sigurimi i shtetit, me qëllimin krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse për njohjen dhe ushtrimin e të drejtave të tyre;

9. të ndërmarrin iniciativa me interes të ndërsjellë edhe me përfshirjen e aktorëve të shoqërisë civile, me fokus transparencën, balancën dhe burimin e informacionit;
10. të zhvillojnë trajnime periodike me stafin e Sekretariatit Teknik të **AIDSSH** në lidhje me detyrimet që burojnë nga ligjet 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

#### **Neni 5**

##### Koordinimi ndërmjet palëve

1. Në zbatim të kësaj **Marrëveshje**, **AIDSSH** dhe **KDIMDP** do të caktojnë nga një person kontakti.
2. Personat e kontaktit do të mbajnë takime ndërmjet tyre në varësi të nevojës për shkëmbim informacioni dhe do të informojnë titullarin e institucionit në lidhje me zbatimin e kësaj **Marrëveshje**.
3. Komunikimi mes palëve do të jetë në formë zyrtare shkresore, duke mos përjashtuar format me të shpejta të komunikimit elektronik.
4. Palët do të njoftojnë reciprokisht në rast se ndryshohet personi i kontaktit.

#### **Neni 6**

##### Përmirësimet, Ndryshimet, Shtesat

1. Palët mund të bëjnë përmirësime, ndryshime dhe/apo shtesa në këtë **Marrëveshje**, bazuar në pëlqimin e ndërsjellë të tyre.
2. Çdo përmirësim, ndryshim dhe/apo shtesë do të bëhet vetëm me shkrim nga titullarët e **AIDSSH** dhe **KDIMDP**, apo nga persona të autorizuar prej tyre dhe do të hyjnë në fuqi pas nënshkrimit të tyre.

#### **Neni 7**

##### Mirëbesimi

1. **AIDSSH** dhe **KDIMDP** do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjellë.
2. Palët duhet të mbajnë në mirëbesim të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë **Marrëveshje**.

#### **Neni 8**

##### Afati i marrëveshjes

1. Kjo **Marrëveshje** do të lidhet për një kohëzgjatje të pacaktuar.
2. **Marrëveshja** mund të përfundojë nga secila **Palë** nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim **Palës** tjetër, (të paktën një muaj përpara).
3. Në rast të përfundimit të kësaj **Marrëveshje**, palët do t’u përmbahen detyrimeve që rrjedhin nga kjo **Marrëveshje**, përsa i përket informacionit të shkëmbyer përpara datës së përfundimit të saj.

## Neni 9

### Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo **Marrëveshje** hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Marrëveshja është hartuar në Tiranë, në katër kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në **Autoritetin për Informimin mbi Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit** dhe dy të tjera në **Zyrën e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**.

Për

**Autoritetin për Informimin mbi  
Dokumentet e ish Sigurimit të Shtetit**

**Gentiana SULA**  
  
\_\_\_\_\_  
**KRYETAR**  


Për

**Komisionerin për të Drejtën e Informimit  
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

**Besnik DERVISHI**  
  
\_\_\_\_\_  
**KOMISIONERI**  
